



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 34, Datë 10.02.2025

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2025 PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS KANALIZIME TË LIDHURA NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV DHE SHOQËRITË UJËSJELLËS KANALIZIME TË LIDHURA NË NIVELET E TENSIONIT 20/10/6 KV TË CILAT FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.02.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 722/1 prot., datë 10.02.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kv për vitin 2025 dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime për vitin 2025”,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 370 prot., datë 27.01.2025, protokolluar në ERE me nr. 722 prot., datë 29.01.2025, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025, për klientët FMF të lidhur në nivelet e tensionit 6/10/20 kV (klientë të rëndësisë së veçantë) si dhe për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV.
- Rezulton se shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve gëzojnë status të veçantë, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 8 të VKM-së nr. 456/2022, e ndryshuar, si shoqëri të cilat sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve.
- Bashkëlidhur aplikimit rezulton gjithashtu dhe shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 7349/1 prot., datë 31.12.2024, me lëndë “Për miratimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a.”. Në këtë shkresë, KESH sh.a. ka paraqitur analizat për Programin Ekonomik-Financiar të vitit 2025 dhe parashikimet për periudhën 2026-2029. Pas shqyrtimit, Këshilli Mbikëqyrës e ka miratuar këtë program me vendimin nr. 10121/1, datë 31.12.2024.

- Gjithashtu, është përcaktuar se çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për furnizimin e shoqërive të Ujësjellës-Kanalizimeve në vitin 2025, për rrjetin me tension 35 kV dhe 20/10/6 kV, do të jetë 5.70 lekë/kWh.
- Bazuar në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që merren në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë:
 - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 Janar 2025-31 Dhjetor 2027 e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.279, datë 16.12.2024, ‘Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 - 31 dhjetor 2027’ prej 0.85 lekë/kWh.
 - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV**, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, vijon të jetë 3.99 lekë/kWh.
 - **Kostot administrative**, prej 1.06 lekë/kWh.
 - **Kthimi për riskun prej 3%** (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën 0.36 lekë/kWh për kategorinë e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe në vlerën 0.17 lekë/kWh për kategorinë Ujësjellës Kanalizime.
- Në zbatim të Metodologjisë si dhe bazuar në të dhënat e aplikimit të FSHU sh.a., çmimet e shitjes së energjisë elektrike për Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë përlllogaritur nga ERE si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime 2025			
Viti 2025		Nivelet e tensionit	
		35 kv	20/10/6 kv
		Njësia	Çmimi
ÇBET	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	5.7
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.17
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë= ÇBET +Pr*ÇBET+TRr+TSHt+CA		Lekë/kWh	9.33
			11.77

- Bazuar në përcaktimet e metodologjisë respektive, elementet e formulës përlllogaritëse si dhe të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizime për vitin 2025 do të jetë:
 - 9.33 Lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV;
 - 11.77 Lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV;

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025, prej 9.33 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025, prej 11.77 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.
3. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE
Erjola SADUSHI